



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 194 Prot.

Tiranë, më 9/5/2011

Lënda: Rekomandim për Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë.

REKOMANDIM

Mbështetur në Ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe nr 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale”, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit, **Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë,**

KONSTATOVA

Më datë 07/02/2011 nga grupi i inspektimit të Zyrës së Komisionerit është zhvilluar inspektimi administrativ pranë kontrolluesit, **Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë,** cilësinë si kontrollues që mbledh dhe përpunon të dhëna personale në ushtrim të qëllimit dhe aktivitetit të tij, me objekt:

- Të dhënat personale që përpunohen (katëgoritë e subjekteve, pedagogë, studentë, punonjës etj.).
- Zbatimi i kushteve dhe kriterëve të parashikuara në nenet 5,6,7,8.9 të ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.
- Si zbatohen të të drejtat e subjekteve të të dhënave personale të parashikuara në nenet 12, 13, 14, 15, 16, 17 të ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.
- Masat për sigurinë e të dhënave personale (neni27).
- A përpunohen të dhëna personale nëpërmjet sistemeve të kamerave (CCTV), nëse ka tabela informuese.

